



Datë: 19.01.2025
Numër Protokolli: 1268/2025

A.nr.27/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.27/2025, të datës, 08.01.2025, të parashtruar nga ankuesit V.L, E.M, M.F, A.S, F.Gj, M.D, H.B, V.J dhe F.K, me autorizues të përbashkët F.K, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.27/2025, e datës 08.01.2025, e parashtruar nga ankuesit V.L, E.M, M.F, A.S, F.Gj, M.D, H.B, V.J dhe F.K.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në mënyrë që ankuesve si në pikën I të dispozitivit, t’iu bëhet kompensimi i diferencës së pagës sipas listës së miratuar për ekspertë dhe atë në mënyrë retroaktive nga muaji shkurt 2023 deri në muajin korrik 2024.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit V.L, E.M, M.F, A.S, F.Gj, M.D, H.B, V.J dhe F.K (tani e tutje referuar si ankuesit), më datë 08.01.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos kompensimit të diferencës së pagës lidhur me pozitën e ekspertit dhe atë për periudhën shkurt 2023 deri korrik 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (me tej MFPT), ndërsa, kjo e fundit, me datë 21.01.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 48/2025 të datës 08.01.2025 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID së ankuesve; Emailin e datës 03.01.2025 nga u.d Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MFPT për V.L dhe A.Q; Kërkesën e datës 03.01.2025 nga V.L për K.D; Emailin e datës 19.11.2024 nga K.D për A.Q; Kërkesën për pagesë retroaktive nga A.Q për K.D të datës 18.11.2024; Vendimin me Nr. 23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. 09/216 të datës 14.08.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Opinionin/Njoftimin e datë 31.03.2023 të MPB-së; Kërkesën për pagesë retroaktive e datës 10.12.2024 nga H.R-R për K.D; Vendimin me Nr. 227/2024 të datës 06.02.2024 për transferim, Akt Emërimit e datës 13.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 24.02.2023 deri 12.12.2024 për ankuesin F.K; Vendimin me Nr. 229/2024 të datës 06.02.2024 për transferim, Akt Emërimit e datës 16.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 17.01.2023 deri 12.12.2024 për ankuesin V.J; Akt Emërimit e datës 13.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 13.12.2023 deri 13.12.2024 për ankuesin H.B; Vendimin me Nr. 226/2024 të datës 06.02.2024 për transferim, Akt Emërimit e datës 13.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 01.02.2023 deri 13.12.2024 për ankuesin V.L; Vendimin me Nr. 232/2024 të datës 06.02.2024 për transferim, Akt Emërimit e datës 16.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 12.02.2023 deri 13.12.2024 për ankuesin M.D; Vendimin me Nr. 233/2024 të datës 06.02.2024 për transferim, Akt Emërimit e datës 13.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 01.02.2023 deri 12.12.2024 për ankuesin F.Gj; Akt Emërimit e datës 13.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 25.01.2023 deri 12.12.2024 për ankuesin A.S; Vendimin me Nr. 243/2024 të datës 06.02.2024 për transferim, Akt Emërimit e datës 13.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 12.01.2023 deri 11.12.2024 për ankuesin M.F; Vendimin me Nr. 249/2024 të datës 06.02.2024 për transferim, Akt Emërimit e datës 13.09.2024 dhe pasqyrën e Trustit për periudhën 01.08.2002 deri 12.12.2024 për ankuesin E.M; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 21.01.2025; Vërtetim për Ndryshime TH/SP/F02 të datës 23.08.2024 për ankuesit; Listën e pagave gusht, dhjetor, nëntor, shtator, tetor të vitit 2024; Vendimin A.nr.1400/2023 të KPMSHCK-së; Opinion ligjor i MPB i datës 31.03.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesit janë të punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa, të njëjti ushtrojnë detyrat si: V.L Udhëheqëse e Divizionit për Operacione të IT-së, E.M Zhvillues i Lart i Bazës së të Dhënave, M.F Administrator i Lartë i Bazës së të Dhënave, A.S Zyrtar i TI-së për Përkrahje, F.Gj Zyrtar i IT-së për Përkrahje, M.D Zyrtare e IT-së për Përkrahje, H.B Zyrtar i TI-së për Përkrahje, V.J Zyrtar i TI-së për Përkrahje, F.K Administrator i Lartë i TI-së për Postën Elektronike,

Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.07/132 të datës 08.03.2023 ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga institucionet që kanë të bëjnë me sistemin shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët dhe dërgimin në Qeveri, të listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, ka përgatit Raportin e punës, listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike dhe listën e pozitave të eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, me Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023. Rrjedhimisht sipas listës së miratuar, për MFPT

janë pranuar si sisteme strategjike të IT-së : Rrjeti kompjuterik dhe Siguria Kibernetike, IT Infrastruktura Fizike dhe Logjistike, Sistemi i Programit të Investimeve Publike-PIP, Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit, Sistemi i Tatimit në Pronë, Sistemi Pensional i Kosovës, Sistemi i Pensionit Kontributiv, Skema e Ndhmës Sociale,-SNS, Sistemi i Tata Warehouse(deponia e të dhënave) dwH, Cost BI, Power BI, kurse, si pozita të eksperteve janë miratuar: Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Sistemeve të IT-së, Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Sigurinë e IT-së, Administrator i Lartë i Ti-së për Rrjeta, Administrator i Lartë i IT-së për Sisteme, Administrator i Lartë i IT-së për VoIP, Administrator i IT-së për Sisteme, Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Aplikacioneve, Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softwerike, Analist i Lartë i Sistemeve Softwerike, Administrator i Lartë Sistemeve Softwerike, Administrator i Lartë i Bazës së të Dhënave.

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, në zbatim të vendimeve të Këshillit, ka përgatitur raportin për plotësim/ndryshim të listës së ekspertëve, ashtu që në listën e ekspertëve lidhur me MFTP janë përfshirë edhe pozitat si Zhvillues i Lartë i Bazës së të Dhënave klasa e pagës B4, Administrator i Bazës së të Dhënave, klasa e pagës B5, Udhëheqës i Divizionit të Operimeve të IT-së, klasa e pagës B3, Zyrtar i It-së për Përkrahje klasa e pagës B7 dhe Help-Desk, klasa e pagës B7, listë kjo e aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më Vendim Nr. 09/216 të datës 14.08.2024.

Ankuesit përmes Drejtorit të Departamentit i Menaxhimit të Sistemeve të TI-së në MFPT, më datë 18.11.2024, i janë drejtuar më kërkesë Njesisë së Personelit të MFPT-ës, për kompensimin retroaktive të diferencës së pagës sipas listës së ekspertëve, por që nuk kanë pranuar përgjigje.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kompensimi i pagës sipas kësaj kategorie bëhet në mënyrë retroaktive nga muaji shkurt 2023 kur ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, duke kërkuar kompensimin për periudhën nga muaji shkurt 2023 deri në muajin korrik 2024.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pretendimeve ankimore të ankuesit, i'u referua Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë:

Nenit 1: *Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë. cilin 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik”*

Nenit 3 nënpikat 1.6, 1.7 dhe 1.9 ku përcaktohet së: 1.6. *klasa e pagës - nënkupton nivelin e pozicionimit në hierarkinë e përgjithshme të funksioneve në shkallën e pagës e që i korrespondon koeficienti i caktuar dhe që përbëhet nga një grup funksionesh, pozitash apo gradash me nivel të njëjtë apo pothuajse të njëjtë kompleksiteti dhe që përfitojnë të njëjtën pagë bazë; 1.7. koeficienti i pagës apo koeficienti – nënkupton shprehjen numerike që korrespondon me klasën dhe grupin e pagës. Bazuar në këtë koeficient, llogaritet paga bazë për çdo pozicion...1. 9. paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji...”* si dhe,

Nenit 14, paragrafi 3: *Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik.*

Kolegji i Këshillit, për vendosje të drejtë lidhur me këtë çështje administrative, mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, ku me nenin 6 ku përcaktohet se: *1. Qeveria e Kosovës më së largu pesë (5) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje emëron komisionin për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në këtë përbërje: 1.1. përfaqësues nga ministria përgjegjëse për administratë publike; 1.2. përfaqësues nga ministria e financave; 1.3. përfaqësues nga zyra e kryeministrit. 2. Institucionet publike që vlerësojnë se posedojnë, menaxhojnë ose koordinojnë sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike, duhet të dërgojnë kërkesat në Komision më së largu dhjetë (10) ditë pas themelimit të komisionit sipas paragrafit 1 të këtij neni. 3. Komisioni për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike pranon kërkesat e dërguara nga institucionet dhe bënë vlerësimin tyre. 4. Komisioni në afat prej pesë (5) ditësh nga përfundimi i afatit sipas paragrafit 2 të këtij neni i dërgon Qeverisë për aprovim Listën e Ekspertëve të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik. 5. Klasat e pozitive si në paragrafin 4 të këtij neni, ju dedikohen mbajtësve të pozitive drejtuese të njësive organizative të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke filluar nga drejtues të departamenteve, drejtorive, divizioneve, sektorëve apo njësive varësisht nga organizimi institucional në nivel të ndryshëm të Ministrive, Agjencive apo institucioneve të tjera të pavarura, koordinatorë qendrorë të procesit të digjitalizimit, deri në nivel të ekspertëve profesional që administrojnë, zhvillojnë ose mbështesin sisteme shtetërore me rëndësi strategjike. 6. Lista e ekspertëve sipas paragrafit 4 të këtij neni duhet të përmbajë minimalisht të dhënat si në vijim: 6.1. sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike; 6.2. institucionet që posedojnë, menaxhojnë e koordinojnë sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike; 6.3. llojet dhe klasat e pozitive të përcaktuara brenda secilit institucion që posedon, menaxhon ose koordinon sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike.*

Andaj, referuar kuadrit ligjor si me lartë, dhe meqenëse pozita e ankueseve janë përfshirë në listat e ekspertëve, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit, pretendimet e ankueseve për kompensim të diferencës së pagës së ekspertit sipas klasave të miratuar nga komisioni kompetent dhe Qeveria janë të bazuara për faktin së paga dhe koeficientet e pagës janë kategori ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili ka hyr në fuqi me datë 05.02.2023 dhe për rrjedhojë efektet juridike të këtij ligji lidhur me pagat rrjedhin nga data e hyrjes në fuqi, përjashtimisht, çështjeve përkatëse të përcaktuara ndryshe me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës AGJ 2316/24. Rrjedhimisht, nisur nga ky konstatim rezulton se kompensimi i ankuesve sipas shtojcës Nr. 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht sipas kategorisë së klasës së pagave të miratuar nga Komisioni përkatës kompetent, duhet të aplikohet në mënyrë retroaktive nga data e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit sjell në vëmendje edhe faktin relevant se Ministra e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave, më datë 31.03.2023, ka përcjell opinion të të gjitha institucionet publike lidhur me efektet e ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me c ‘rast sipas pikës 4 të opinionit sqarohet se: *Punonjës të cilëve vet shtojca përkatëse e Ligjit, u është përcaktuar klasifikimi i posaçëm, p.sh: ekspertë sipas shtojcës së posaçme, specialistët, inspektorët, punonjësit në arsim, shëndetësi, art, kulture e trashëgimi kulturore apo një fushë tjetër ?(vijon korrigjimi edhe në ditët dhe javët në vazhdim-pagat u barazohen retroaktivisht nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit).*

Andaj, theksuar si me lart Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrejdhimisht aprovoj ankesën si të bazuar dhe detyroj Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Personelit të MFPT që të bëjnë kompensimin e diferencës së pagës për ankuesit nga muaji shkurt 2023 deri në muajin korrik 2024, bazuar në koeficientin e

përcaktuar sipas raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike dhe të miratuar me vendimet e Qeverisë së Kosovës.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.27/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve F.K;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MFPT dhe
- Arkivit të KPMSHCK -së.